



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 528/1 prot.

Tiranë, më 02.04.2024

V E N D I M

Nr. 88, Datë 02.04.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 193, datë 27.09.2023, e bërë nga H.RR kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë (ZVAP Kavajë) dhe Shkollës 9-vjeçare “Herbert”, Kavajë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “shtatzënisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 38, datë 08.11.2018, jam emëruar mësuese pranë shkollës 9-vjeçare “Herbert”, në pozicionin si mësuese në profilin “Gjuhë Shqipe”.

Me Vendimin nr. 24, datë 11.09.2023 nga ana e shkollës “Herbert”, mbi bazën e orientimit të dhënë nga ana e ZVAP Kavajë, më është ndërprerë përfundimisht marrëdhënia ime e punësimit në arsim, duke më nxjerrë jashtë sistemit arsimor.

Aktualisht jam shtatzënë e shumë e tronditur nga ky lloj largimi nga puna nga ana e palëve të sipërcituara, pasi dyshoj se largimi im nga puna ka të bëjë edhe me shtatzëninë time, duke më penalizuar që të mos përfitoj të drejtat financiare dhe shoqërore që më garanton ligji në këto raste, duke më flakur në rrugë padrejtësisht në mënyrë arbitrare.

Në e-mail-in e ZVAP Kavajë citohej se unë H.RR kam dalë me 0 orë pune dhe nuk ka vend tjetër në asnjë shkollë ku mund të më transferonin dhe duhej të largohesha nga sistemi.

Ky orientim dhe kjo vendimmarrje e shkollës “Herbert”, është marrë mbi bazën e “ndikimit të paligjshëm të ZVAP Kavajë”, e cila në kundërshtim me ligjin orienton që marrëdhënia ime e

punës të ndërpritet dhe duhet të më nxjerrin me çdo kusht nga sistemi arsimor pa më dhënë asnjë lloj mundësie tjetër.

Në rastin konkret jemi qartë para një veprimi arbitrar të ardhur në kundërshtim me Ligjin 69/2012 “Për Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe me Udhëzimin e MAS me Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit, e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në Institucionet Arsimore Publike të Arsimit Parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, i ndryshuar.

Ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë se “Mësuesit që janë me vendim definitiv”, duhet ti ofrohen alternativa të tjera si dhe e kanë detyrim ligjor ti gjejnë orë punë dhe ti plotësojnë në mënyrë që të mos të dalë fare nga sistemi, si dhe mos ti heqin nga puna. Mua nuk më është ofruar asnjë punë alternative, as me anë të e-mail-it e as me njoftim zyrtar dhe kjo përbën shkelje të rëndë të procedurave të punonjësve të arsimit.

Dua të theksoj se në datë 14.09.2023 është hapur portali për pozicionin e punës “Mësues në profilin Gjuhe Shqipe dhe Letërsi”, ku ka pasur vende të lira dhe kërkesë për këtë profil në:

- 1. shkollën e mesme tek Instituti i Riedukimit të të Miturve;*
- 2. shkollën 9-vjeçare Cikallesh për klasa kolektive;*
- 3. shkollën 9-vjeçare “Sadi Tatani”, Rrakull;*
- 4. shkollën vjeçare “Kryezi”, shkollë vartëse e shkollës 9-vjeçare Memzotaj.*

dhe kjo tregon që ka pasur kërkesë dhe orë plotësuese që mund të mi propozonin mua si opSION, pasi unë isha me vendim definitiv, ky fakt konfirmon tendencën dhe paligjshmërinë e palëve të sipërcituar të cilët janë në shkelje ligjore, pasi kanë punësuar njerëz të tjerë në këto vende pune duke më hequr mua që më takon sipas ligjit”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1050/1, datë 09.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi/largimi, kontrata pune, etj).
 - Kopje të informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga drejtori i shkollës “Herbert”, lidhur me ngarkesën mësimore, vlerësimin e dosjes dhe pikëzimit të të gjithë mësuesve të profilit gjuhë shqipe.
 - Kopje të vlerësimit të dosjeve dhe renditjes së mësuesve të profilit gjuhë shqipe, të bërë nga ZVAP-ja.
 - Informacion dhe kopje të lëvizjeve paralele të detyrueshme/dëshirë të mësuesve të profilit gjuhë shqipe, sipas renditjes së shpallur nga ZVAP-ja.

Me shkresën me nr. 1214/1, datë 19.10.2023, ZVAP Kavajë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Me Vendimin nr. 38, datë 08.11.2018, H.RR është emëruar mësuese e profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në shkollën 9-vjeçare “Herbert”, me kontratë pune pa afat.

Në vitin shkollor 2021-2022 ngarkesa mësimore e kësaj mësueseje ka qenë 12 orë mësimore me nxënës me aftësi të kufizuar, 5 orë gjuhë shqipe, 1 orë teatër dhe 2 orë kujdestari, ndërsa në

vitin shkollor 2022-2023 ngarkesa mësimore ka qenë në total 20 orë, nxënës me aftësi të kufizuar (jashtë profili).

Bazuar në Udhëzimin nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion në një vend pune si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, mësuesja H.RR duhej të ishte futur për lëvizje paralele të detyruar që në vitin shkollor 2021-2022, pasi rezultonte me vetëm 6 orë mësimore në profil. Nga drejtoria e shkollës nuk është kryer procedura për lëvizje paralele të detyruar dhe as nuk i është ndryshuar afati i kontratës, në zbatim të udhëzimeve të cituara më lart.

Në qershor të vitit 2022 mësuesja mori lejen e lindjes dhe duke marrë në konsideratë faktin se ishte me leje lindje, nuk është futur në procedurat për lëvizje paralele të detyrueshme në vitin shkollor 2022-2023, edhe pse rezultonte pa ngarkesë mësimore në profilin e saj.

Siç e cituam më lart, mësuesja H.RR përgjatë gjithë vitit shkollor 2022-2023 ka qenë me leje lindje dhe është rikthyer në shkollë me datë 25.05.2023. Ka vazhduar procesin mësimor deri me datë 31.06.2023, pasi nga data 01.07.2023 mësuesja ka vazhduar lejen vjetore. Me shkresën nr. 189, datë 03.10.2023, drejtori i shkollës 9-vjeçare Herbert njofton ZVAP-in se për vitin mësimor 2023-2024 mësuesja H.RR nuk është paraqitur asnjë ditë në punë ndërkohë që marrëdhënia e punës i është zgjidhur në datë 11.09.2023, madje nuk është paraqitur as kur është njoftuar nga Drejtori i shkollës për të diskutuar mbi ecurinë e marrëdhënies së saj të punës.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, drejtori i shkollës 9-vjeçare Herbert ka bërë parashikimin e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2023-2024, nga ku ka rezultuar që në profilin Gjuhë Shqipe kishte vetëm 20 orë mësimore në nivel shkolle. Shkolla 9-vjeçare Herbert ka pasur dy mësuese të këtij profili dhe dosjet personale të tyre janë futur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve në shkollë në procedurë pikëzimi sipas shtojcës 2.1, të Udhëzimit 12, të cituar më lart. Nga kjo procedurë mësuesja H.RR është renditur e fundit në pikëzimin e kryer nga komisioni dhe dosja e saj personale është përcjellë me postë në ZVAP Kavajë brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 12/2021. Ajo që vlen të theksohet është fakti që nga ana e mësueses nuk kemi pasur asnjë ankesë për procedurën e ndjekur as në nivel shkolle dhe as nga ZVAP Kavajë.

Bazuar në pikën 3 të Kreut 6 të Udhëzimit 12/2021, ZVAP Kavajë në bashkëpunim me IA-të nuk identifikoi asnjë vend të lirë pune për të sistemuar në profilin Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, mësuesen H.RR.

Vendet e punës të profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi të cilat pretendon mësuesja që duhej ti ishin ofruar si mundësi përzgjedhjeje, janë vende të lira pune me kontratë me afat dhe kërkesat për personel mësimor kanë ardhur pas përfundimit të afatit të procedurave të lëvizjes paralele, i cili ishte 31.08.2023 dhe mësuesja, duhej të ishte pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë” 2023 që ti ofroheshin këto vende pune.

Pika 13, kreu 7, i Udhëzimit 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion në një vend pune si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” citon: “Mësuesi që ka bërë kërkesë për lëvizje paralele me dëshirë si dhe mësuesi që rezulton pa ngarkesë mësimore, në rastet kur sistemohen në një vend të lirë pune, punësohen me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar”. Ky parashikim ligjor nuk na lejon që mësuesi që është për lëvizje paralele të detyrueshme, ti ofrojmë vende pune me kontratë me afat, dhe që mësuesja H.RR të përfitonte nga këto vende të lira pune duhej të ishte pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë” 2023.

Referuar pikës 12, kreu 7 të Udhëzimit 12/2021, mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë dhe mbeten të pa sistemuar si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi. Pra, që vendet e pretenduara nga mësuesja, t’i ofroreshin asaj, duhej të ishte pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë” 2023.

Duke qenë para këtij fakti që nuk kishim asnjë vend të lirë punë me kontratë pune pa afat dhe në zbatim të nenit 144, pika 1, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, filloi procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me mësuesen H.RR, marrëdhënie që është zgjidhur me datë 11.09.2023.

Si përfundim shkaku i zgjidhjes së marrëdhënies së punës me mësuesen H.RR ka qenë fakti që nuk kishte ngarkesë mësimore në shkollën ku ishte e emëruar dhe brenda ZVAP Kavajë, nuk kishim asnjë vend të lirë pune me kontratë pa afat për t’ia ofruar”.

Me shkresën me nr. 203, datë 19.10.2023, Shkolla 9-vjeçare “Herbert”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Mësuesja në vitin shkollor 2022-2023 ka qenë me leje lindje deri me datë 25.05.2023. Kohëzgjatja e saj në punë ka qenë vetëm një muaj dhe më pas ka filluar lejen vjetore si gjithë mësuesit e tjerë.

Në bazë të Urdhrit nr. 41, datë 15.06.2023, “Për parashikimin e ngarkesës mësimore, numrin e punonjësve arsimorë dhe numrin e nxënësve për klasë për vitin mësimor 2023-2024” e ardhur nga ZVAP Kavajë, drejtorja e shkollës ka nxjerrë Urdhër nr. 4, datë 15.06.2023 me nr. 134 prot, për parashikimin e ngarkesës mësimore, numrin e punonjësve arsimor si edhe numrin e nxënësve për klasë për vitin mësimor 2023-2024. Në bazë të këtij Urdhri kemi parashikuar ngarkesën mësimore për vitin shkollor 2023-2024.

Në zbatim të Urdhrit nr. 5, datë 15.06.2023 të nxjerrë nga drejtorja e shkollës, për ngritjen e komisionit përgjegjës për procedurat e lëvizjeve paralele në rastet e rezultimit pa ngarkesë mësimore të mësueseve për vitin shkollor 2023-2024, në profilet Gjuhë Shqipe dhe Edukim Fizik, kemi ngritur komisionin e vlerësimit të dosjeve.

Mësuesit e lëndës Gjuhë Shqipe i janë nënshtruar procedurave të lëvizjes paralele me detyrim për arsye se shkolla kishte vetëm 20 orë në dispozicion (normë e përshtatshme për një mësues). Nga kjo procedurë mësuesja H.RR është renditur e fundit në pikëzimin e komisionit

në nivel shkolle me një diferencë të madhe pikësh në raport me kolegen dhe dosja është përcjellë me postë në ZVAP Kavajë, brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin 12/2021.

Në datë 02.09.2023, ZVAP Kavajë njofton me e-mail si më poshtë: “ZVAP Kavajë nuk ka asnjë vend të lirë pune në këtë profil. Drejtoria e shkollës të marrë masa që mësuesit që ngelin pa ngarkesë mësimore të vijojë procedurat konform përcaktimeve të pikës 12 të kreut 7, të Udhëzimit të MASR nr. 12/2021”, i ndryshuar.

Referuar pikës 12, kreu 7, të Udhëzimit 12/2021, mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë dhe mbeten të pa sistemuar si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.

Në zbatim të nenit 144, pika 1 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ka filluar procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me mësuesen H.RR.

Në datë 02.09.2023 lajmëroj mësuesen H.RR me e-mail, për marrjen e masës nga shkolla për mësuesit që ngelen pa ngarkesë mësimore, mbështetur në përcaktimet e pikës 12, të kreut 7 të Udhëzimit nr. 12/2021.

Mësueses i është bërë njoftim me postë në datën 04.09.2023, me nr. 156/1 prot, për tu paraqitur në drejtorinë e shkollës me datë 07.09.2023, ora 10.00, për të diskutuar rreth marrëdhënies së punës me institucionin.

Mësuesja nuk është paraqitur dhe nuk është përgjigjur as me e-mail dhe as me postë për arsyet e mosparaqitjes. Për këtë është mbajtur Procesverbal nr. 157/1, datë 07.09.2023 nga komisioni i shkollës. Institucioni arsimor i gjendur në këto rrethana merr Vendimin nr. 24, datë 11.09.2023, për zgjidhjen e marrëdhënies së punës ndërmjet IPAP shkollës 9-vjeçare “Herbert” dhe punëmarrësit H.RR, me pozicion mësuese në profilin Gjuhë Shqipe, për mos plotësim me normë mësimore. Për këtë vendim është vënë në dijeni ZVAP Kavajë dhe H.RR.

Shkolla 9-vjeçare “Herbert” ndjehet e indinjuar që akuzohet për diskriminim ndaj mësueses H.RR, për shkak të shtatzënisë së saj (gjë për të cilën nuk kemi qenë në dijeni). Zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkak të mos plotësimit me normë mësimore gjë për të cilën mësuesja është e vetëdijshme se procesi ka qenë shumë i rregullt, ku mësuesja në fjalë ka qenë prezente dhe në dijeni për gjithë hapat e ndjekur dhe në asnjë moment nuk ka pretenduar për parregullsi apo njëanshmëri”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1050/4, datë 06.12.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 20.12.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit si më poshtë:

Për ZVAP Kavajë:

- Informacion dhe kopje të emërimeve të mësuesve (lëvizjeve paralele të detyrueshme/dëshirë) të profilit gjuhë shqipe, sipas renditjes së shpallur nga ZVAP-ja, me Procesverbalin nr. 913, datë 25.08.2023.
- Informacion dhe kopje të emërimeve të mësuesve të profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në shkollën e mesme Instituti i Riedukimit të të Miturve; shkollën 9-vjeçare Cikallesh; shkollën 9-vjeçare “Sadi Tatani”, Rrakull; shkollën 9-vjeçare “Kryezi”.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjekti ankues, e përfaqësuar nga bashkëshorti z. K.Rr dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, znj. R.X, me detyrë Drejtore e ZVAP Kavajë, z. Z.E, me detyrë Drejtor i shkollës “Herbert” dhe përfaqësueses me autorizim nr. 1564, datë 20.12.2023, të ZVAP Kavajë, znj. K.Gj, me detyrë specialiste juriste në ZVAP Kavajë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, z. K.Rr në mes të tjerash deklaroi se: *“Bashkëshortja sapo ka lindur dhe prandaj kam ardhur për ta përfaqësuar. Kur bashkëshortja ishte shtatzënë, 6-muajshe, shkolla bëri pikëzimin për mësueset e lëndës gjuhë shqipe. Një vit më parë gruaja ka qenë mësuese ndihmëse, pasi nuk kishte orë si mësuese e gjuhës shqipe. Zyra arsimore nuk i ka ofruar asnjë vend pune, pasi ajo ka qenë mësuese definitive. Çdo vit shkollor i jam drejtuar zyrës arsimore për lëvizje paralele dhe nuk është gjetur vend si mësuese e profilit gjuhë-letërsi, ndërkohë që ka punësuar shumë mësues të tjerë. Këtë vit bashkëshortja nuk ka aplikuar në portal, pasi ishte shtatzënë. Tërheq ankesën drejtuar shkollës, pasi procedurat e vlerësimit të mësuesve janë bërë në rregull”.*

Gjatë seancës dëgjimore, drejtori i shkollës “Herbert”, në mes të tjerash deklaroi² se: *“Janë bërë katër emërime për mësues ndihmës, të cilët kanë ardhur si rezultat i kërkesës që ka bërë shkolla, pas datës 1 shtator 2023 dhe janë mësuese me kontrata me afat. Shkolla ka bërë kërkesë për mësues me arsim special por nga portali erdhën mësues të profileve të tjera sipas renditjes. Ankuesja në vitin shkollor 2021-2022 nuk është futur në vlerësim sepse ka pasur 6 orë në profilin e saj dhe ngarkesën tjetër me nxënës me aftësi të kufizuara, ndërsa në vitin shkollor 2022-2023 nuk është futur në vlerësim sepse ka qenë me leje lindje dhe në datë 26.05.2023 është paraqitur në shkollë dhe ka qëndruar deri në datë 30 qershor 2023 dhe kur erdhi nuk mund ti ndryshonim statusin si mësuese për nxënësit me aftësi të kufizuara sepse periudha ishte e shkurtër, nga data 26.05.2023 deri në 14.06.2023, që mbyllet shkolla. Unë si drejtor nuk kam pasur dijeni për shtatzëninë e ankueses sepse ishte periudhë vere”.*

² Referuar deklarimeve të bëra, min 41.50, e në vijim.

Përfaqësueset e ZVAP Kavajë, në mes të tjerash deklaruan³ se: “Ankuesja është emëruar si mësuese definitive në profilin Gjuhë Shqipe në vitin 2018. Ankuesja në muajin qershor 2022 ka marrë leje lindje deri në datë 26.05.2023 dhe me datë 1 gusht 2023 ka filluar lejen vjetore. Në periudhën e muajit gusht, zhvillohen procedurat për ngarkesat mësimore dhe ankuesja rezultoi pa ngarkesë mësimore në lëndën gjuhë shqipe, u rendit e dyta në shkollë dhe drejtorja e shkollës dërgoi dosjen në zyrën arsimore për lëvizje paralele të detyruar. Afati për lëvizje paralele është deri në datë 30 gusht 2023. Për vitin shkollor 2022-2023 ankuesja ka qenë me leje lindje dhe nuk ka bërë kërkesë për lëvizje paralele, ndërsa për vitin shkollor 2021-2022 ka bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe i është ofruar një vend punë si mësuese në shkollën Cikallesh, të cilën ankuesja nuk e ka pranuar. ZVAP Kavajë në bashkëpunim me drejtorët e shkollave për vitin shkollor 2023-2024, ka konstatuar se deri në fund të muajit gusht, nuk ka pasur asnjë vend të lirë për mësues të profilit gjuhë shqipe. Përsa i përket Institutit të Rehabilitimit të të Miturve, ku pretendon ankuesja, informoj se numri i orëve në momentin që është bërë llogaritja, ishte 20 orë dhe mësuesi ishte në institucion i emëruar. Nga fundi i muajit shtator erdhi një urdher nga MAS për të ndarë klasën në një mënyrë tjetër nga sa ishte parashikuar tek marrëveshja mes MAS dhe Ministrisë së Drejtësisë. Në atë vend është punësuar një mësuese nga portali, me kontratë me afat deri në fund të vitit shkollor.

Në ZVAP nga drejtorët e shkollave ka ardhur vendimi për lëvizje të detyruar për ankuesen dhe mësuesen O.K, por duke qenë se kjo e fundit ishte e renditur më lart se ankuesja, është sistemuar në dy shkolla. Mësueset S.G, E.D dhe Sh.Ç që janë cituar, janë sistemuar brenda të njëjtës shkollë ku ishin nga drejtorët përkatës, pasi këto mësuese kanë qenë lëvizje me dëshirë, pasi udhëzimi dhe zyra arsimore i jep prioritet lëvizjeve të detyruara, pasi mësuesit nuk kanë ngarkesë dhe duhet të sistemohen, ndërsa lëvizjet me dëshirë nuk kanë prioritet pasi nëse ka ngarkesë ofrohet, nëse nuk ka nuk ofrohet. Udhëzimi 12/2021 përcakton se mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje me dëshirë dhe të detyrueshme, duhet të punësohen me kontratë pune pa afat. Mësuesit që emërohen me kontratë me afat duhet të hynë me portal.

Në shkolla ka mësues që janë jashtë profili dhe kanë nxënës me aftësi të kufizuara, por atyre mësuesve i është ndryshuar vendimi i emërimit, nuk janë më mësues në profilin e tyre por në profilin mësues ndihmës, ndërsa ankuesja ka vazhduar mësimin me nxënës me aftësi të kufizuara, por pa i ndryshuar vendimi i emërimit.

Ne si zyrë arsimore nuk kemi asnjë dijeni, dokument apo raport mjekësor për shtatzëninë e ankuses, pasi punëdhënës është drejtori i shkollës dhe jo zyra arsimore”.

- Me shkresën nr. 322, datë 20.02.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ZVAP Kavajë dhe shkolla “Herbert”, dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të plotë të kërkesës për lëvizje paralele me dëshirë të bërë nga H.RR në vitin 2021 dhe të mospranimit nga ana e saj të propozimit për lëvizje në shkollën 9-vjeçare Cikallesh.

³ Referuar deklarimeve të bëra, min 15.00, e në vijim.

- Kopje të plotë të procedurës së emërimit të mësueses O.K, për vitin shkollor 2023-2024.
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për emërimet e katër mësueseve ndihmëse në shkollën “Herbert”, për vitin shkollor 2023-2024 (kërkesa nga shkolla, renditja e portalit, kontrata e punës, etj).

ZVAP Kavajë me shkresën nr. 404/1, datë 29.02.2024 dhe Shkolla “Herbert” me shkresën datë 28.02.2024, dërguan kopje të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë*

procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të ankueses.

Në nenin 60, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: “1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit...”.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar.

Procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar kryhen bazuar në dispozitat e këtij udhëzimi.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Ankuesja nga data 10.11.2015 deri në datë 11.09.2018 ka qenë e punësuar në shkollë të ndryshme të ZVAP Kavajë në pozicionin si mësuese me emërim të përkohshëm, për lëndën e profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.

Me Vendimin nr. 38, datë 08.11.2018, “Për emërim definitiv të punonjësit arsimor”, H.RR është emëruar me afat të pacaktuar, si mësuese e profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, në shkollën 9-vjeçare Qerret.

Me shkresën nr. 56, datë 04.12.2022, mes shkollës 9-vjeçare “Herbert” Qerret dhe ankueses është lidhur kontrata mbi kohëzgjatjen e lejes së lindjes të H.RR, nga data 04.12.2022 deri në datë 25.05.2023. Në datë 26.05.2023 ankuesja ka dalë në punë dhe ka patur ngarkesë mësimore të plotë si mësuese ndihmëse me nxënës më aftësi të kufizuara.

ZVAP Kavajë me shkresën nr. 612, datë 15.06.2023, ka nxjerrë Urdhrin nr. 41, për parashikimin e ngarkesës mësimore, numrin e punonjësve arsimorë si dhe numrin e nxënësve për klasë për vitin mësimor 2023-2024, për të gjitha institucionet arsimore në varësi të ZVAP Kavajë dhe fillimin e procedurave të lëvizjeve paralele të detyrueshme të punonjësve arsimorë që rezultojnë pa ngarkesë mësimore.

Në pikën 5 të këtij urdhri parashikohet se: “Dorëzimi i dosjeve personale të mësuesve për lëvizje paralele të detyrueshme të kryhet me anë të shërbimit postar drejtuar ZVAP Kavajë brenda datës

15.07.2023”, ndërsa në pikën 8 parashikohet se: “Procedura për lëvizje paralele të detyrueshme/dëshirë në nivel ZVAP të përfundojë në afatin deri në 1 (një) muaj para datës së fillimit të shkollës⁴”.

Në zbatim të urdhrin sipërcituar shkolla Herbert, ka nxjerrë Urdhrin nr. 4, datë 15.06.2023, “Për parashikimin e ngarkesës mësimore, numrin e punonjësve arsimore si dhe numrin e nxënësve për klasë për vitin mësimor 2023-2024”, në të cilin ka urdhëruar që brenda datës 15.07.2023 të bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore, numri i punonjësve arsimorë dhe përcaktimi faktik i numrit të nxënësve për klasë për vitin 2023-2024.

Në Kreu 7, pika 10 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Kur në një institucion arsimor bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i IAP-së krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde”. Ndërsa në pikën 11, përcaktohet përbërja e Komisionit për shqyrtimin e dosjeve: “Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga drejtori i shkollës (kryetar), një mësues i atij institucioni arsimor parauniversitar që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar) dhe kryetari i këshillit të prindërve të po atij institucioni arsimor parauniversitar (anëtar). Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës, për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1 të këtij Udhëzimi, dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet me ID-të përkatëse”.

Referuar shkresës nr. 139, datë 16.06.2023 të shkollës Herbert, në mes të tjerash rezultojnë se në lëndën Gjuhë Shqipe kishte ngarkesë mësimore vetëm 20 orë, ndërkohë që ishin të emëruara dy mësuese të profilit Gjuhë Shqipe, E.D dhe H.RR.

Në zbatim të urdhrin të ZVAP Kavajë (sipërcituar) dhe të Udhëzimit 12/2021, shkolla Herbert, ka nxjerrë Urdhrin nr. 5, datë 15.06.2023, “Për ngritjen e Komisionit përgjegjës për procedurat e lëvizjeve paralele në rastet e rezultimit pa ngarkesë mësimore të mësuesve për vitin mësimor 2023-2024 në profilet përkatëse”, në të cilin ka urdhëruar krijimin e komisionit përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve për mësuesit të cilët rezultojnë pa ngarkesë mësimore për vitin 2023-2024 në profilin: Gjuhë Shqipe dhe Edukim Fizik.

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve për mësuesit të cilët rezultojnë pa ngarkesë mësimore të shkollës Herbert, kanë bërë vlerësimin e dosjeve të mësuesve të lëndës Gjuhë Shqipe, bazuar në kriteret e vlerësimit sipas shtojcës 2.1, të Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 10.06.2021.

⁴ Referuar Urdhrin të Përbashkët nr. 191, datë 20.04.2023 “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar”, përcaktohet se: “1. a) Mësimet fillojnë më 11 shtator 2023 dhe mbarojnë më 14 qershor 2024”.

Referuar tabelës së vlerësimit për mësueset e lëndës Gjuhë Shqipe, rezulton se mësuesja E.D është vlerësuar me 27 pikë, duke u renditur e para, ndërsa mësuesja H.RR është vlerësuar me 15 pikë, duke u renditur në vend të dytë. Shkolla Herbert me shkresën nr. 141, datë 19.06.2023, drejtuar ZVAP Kavajë ka dërguar dosjen personale të H.RR, e cila rezultonte pa ngarkesë mësimore në profilin Gjuhë Shqipe.

Në Kreun 1, pika 7 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, përcaktohet se: “7. Vendet e lira të punës në përfundim të vitit shkollor, shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe pasi janë sistemuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar deri në 1 (një) muaj para fillimit të vitit mësimor”.

Në Kreun 6, pika 3 të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet se: “3. ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtoritë e IA-ve publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike”.

Ndërsa në Kreun 8, pika 2 dhe 3 të Udhëzimit të sipërcituar, parashikohet se: “2. Vendet e lira të punës, të paplotësuara në përfundim të vitit shkollor u ofrohen në fillim mësuesve nga lista për lëvizje paralele brenda ZVAP, sipas renditjes. 3. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP-ja përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online”.

ZVAP Kavajë me shkresën nr. 913, datë 25.08.2023, Procesverbal nr. 02, datë 25.08.2023, ka bërë dokumentimin e renditjes së mësuesve për lëvizje paralele të detyrueshme/lëvizje me dëshirë pas verifikimit të dosjeve personale dhe shtojcës 2.1 në nivel të ZVAP Kavajë. Pas shqyrtimit të dosjeve të mësuesve për lëvizje paralele të detyrueshme e me dëshirë, renditja e mësuesve të profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, rezulton si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Profili	Lëvizje paralele me dëshirë/e detyruar	Pikët totale, Shtoja 2.1
1	S. G	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Lëvizje paralele me dëshirë	26.5
2	E. D	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Lëvizje paralele me dëshirë	26
3	O. K	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Lëvizje paralele e detyruar	24.5
4	Sh. Ç	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Lëvizje paralele me dëshirë	17.5
5	H. Rr	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	Lëvizje paralele e detyruar	15.5

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ZVAP Kavajë, për lëvizjen paralele të detyruar të mësuesve të profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi mbështetur në kërkesat e drejtorëve të institucioneve arsimore, ka pasur një vende pune të lirë për mësues në shkollën 9-vjeçare Karpen, ku plotësohen orët edhe në shkollën 9-vjeçare Bago.

ZVAP Kavajë me shkresën nr. 936, datë 30.08.2023, ka nxjerrë njoftimin se procedura e lëvizjeve paralele me dëshirë dhe të detyrueshme për profilet “Arsim fillor” dhe “Gjuhë shqipe dhe Letërsi”, do të zhvillohet në datë 31.08.2023, në ambientet e ZVAP Kavajë.

Referuar pikës 2 të kreut 8 të Udhëzimit 12/2021, në të cilin parashikohet se vendi i lirë i punës i ofrohet mësuesit për lëvizje paralele që është i renditur me pikë më shumë, rezulton se vendi i punës në shkollën Karpen, i është ofruar mësueses O.K, e cila ishte e renditur në vend të tretë, me 24.5 pikë, ndërsa mësuesja H.RR ishte e renditur në vend të pestë, me 15.5 pikë.

Referuar Deklaratës nr. 970, datë 31.08.2023, mësuesja O.K ka pranuar vendin e punës në shkollën Karpen dhe mes palëve është lidhur Kontrata individuale e punës pa afat, me nr. 396, datë 31.08.2023.

ZVAP Kavajë në përfundim të procesit, me e-mail-in datë 02.09.2023, ka njoftuar shkollën Herbert dhe mësuesen H.H.Rr, me përmbajtjen si më poshtë: *“Në ZVAP Kavajë keni sjellë për lëvizje paralele të detyruar me 0 ngarkesë mësimore mësuesen H.RR. ZVAP Kavajë nuk ka asnjë vend të lirë pune në këtë profil. Drejtoria e shkollës të marrë masat që mësuesit që ngelen pa ngarkesë mësimore të vijojë procedurat konform përcaktimeve të pikës 12, të kreut 7 të Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 10.06.2021”*.

Në kuptim përse më sipër, për ankuesen nuk ishte mundësia për ta sistemuar në shkollat që ka nën administrim ZVAP Kavajë. Për këtë është vënë në dijeni ankuesja me e-mail-in datë 02.09.2023.

Në pikën 12, të kreut 7 të Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 10.06.2021, përcaktohet se: *“Mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij Udhëzimi”*.

Në Kreu 11, pika 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, përcaktohet se: *“1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionet e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë-pune pas shpalljes së tyre”*.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se H.RR, nuk ka ankimuar brenda afatit të kërkuar, asnjë prej fazave të përshkruara më sipër, si vlerësimin e dosjes të bërë nga komisioni i shkollës ashtu dhe vlerësimin e renditjen e mësuesve për lëvizje paralele të bërë nga komisioni i ZVAP Kavajë.

Referuar shkresës nr. 2608/1, datë 29.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Paruniversitar (DPAP), drejtuar H.RR, kjo e fundit informohet se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj, protokolluar me tonën nr. 2608, datë 27.09.2023 “Ankim”, ju sqarojmë se: Në ankesën tuaj, keni depozituar njoftimet e kryera nga ZVAP Kavajë, për pozicione pune në profilin Gjuhë Shqipe dhe Letërsi me kontratë me afat deri në përfundim të vitit shkollor 2023-2024 dhe zëvendësim raporti*

paaftësie. Për sa më sipër, duke parë që pozicionet e punës të sipërcituara janë me kontratë me afat, ZVAP Kavajë, nuk ka pasur vende të lira pune për sistemimin tuaj me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar, atëherë shkolla Herbert ka filluar procedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës sipas Udhëzimit nr. 12/2021, të ndryshuar”.

Bazuar në nenin 144/1 të Kodit të Punës parashikohet: “1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të”.

Përsa më sipër, në kushtet kur ankuesja kishte mbetur pa ngarkesë mësimore, nga ana e shkollës Herbert, me shkresën nr. 156/1, datë 04.09.2023, H.RR është njoftuar për nisjen e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe për t’u paraqitur në takim në datën 07.09.2023, ora 10.00, për të diskutuar rreth marrëdhënies së punës me institucionin.

Sa më sipër, njoftimi i është komunikuar ankueses por ajo nuk është paraqitur, si dhe rezulton se është respektuar detyrimi ligjor që njoftimi për takimin duhet të realizohet të paktën 72 orë para takimit. Në datën 07.09.2023, rezulton që është mbledhur komisioni i shkollës Herbert për të realizuar takimin, por ankuesja nuk është paraqitur, fakt ky që pasqyrohet në procesverbalin me nr. 157/1, datë 07.09.2023. Nga përmbajtja e këtij procesverbali, punëdhënësi deklaroi se mësuesja H.RR rezultoi pa normë e për pasojë duhet të zgjidhet kontrata e punës. Nga përmbajtja e procesverbalit rezultoi se: “Mësuese H.RR pasi është njoftuar më parë me e-mail dhe letër zyrtare, nuk është paraqitur në drejtorinë e shkollës”.

Bazuar në nenin 144/3 të Kodit të Punës parashikohet se: “3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit”. Me Vendimin nr. 24, datë 11.09.2023, shkolla Herbert, ka vendosur lirim nga detyra të ankueses, duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Duke u bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shkolla “Herbert”, ka respektuar procedurën e parashikuar nga Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, për vlerësimin e dosjes së ankueses dhe ka respektuar nenin 144, të Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen.

- Lidhur me pretendimin e ankueses për emërimin e mësueseve të profilit Gjuhë Shqipe, në shkollat: 9-vjeçare Memzotaj, me shkollë vartëse “Kryezi”; 9-vjeçare “Sadi Tatani”, Rrakull; 9-vjeçare Memzotaj, me shkollë vartëse Cikallesh; shkolla e mesme e bashkuar “11 Shkurti” me shkollë vartëse Instituti i Riedukimit të të Miturve; dhe emërimit të mësuesve ndihmës në shkollën 9-vjeçare “Herbert”.

Në pikën 12 dhe 13, kreu 7, i Udhëzimit 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit, e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar,

parashikohet se: “12. Mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij Udhëzimi. 13. Mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe mësuesit që kanë rezultuar pa ngarkesë mësimore, në rastet kur sistemohen në një vend pune të lirë, punësohen me kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar”.

Në pikën 7, të kreut 8, të Udhëzimit 12/2021, të ndryshuar, parashikohet se: “Mësuesit ndihmës do të punësohen nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Arsim special”, sipas procedurave të këtij Udhëzimi”, ndërsa në pikën 3, të kreut 9, parashikohet se: “3. Në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP-ja vepron si më poshtë: a) b) Nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve duke i renditur të gjithë kandidatët e të gjitha profileve dhe do të punësojë kandidatët që kanë renditjen më të mirë”.

Referuar parashikimeve të udhëzimit sipërcituar, por dhe përgjigjes së DPAP drejtuar ankueses në datë 29.09.2023 dhe përgjigjes së ZVAP Kavajë drejtuar Komisionerit, rezulton se mësuesit që konkurojnë për vende pune me afat, duhet të jenë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe deklaramit⁵ të bashkëshortit të ankueses, z. K.R, të bërë gjatë seancës dëgjimore datë 20.12.2023, rezulton se ankueses H.RR, me Vendimin nr. 24, datë 11.09.2023, i është zgjidhur kontrata e punës, dhe për vitin shkollor 2023-2024, ajo nuk ka qenë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe në këtë kuptim ZVAP Kavajë, nuk ka pasur asnjë mundësi që ti ofronte ankueses, vend pune me kontratë me afat.

Referuar kërkesave për punësimin e një punonjësi arsimor të profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi të bërë nga drejtuesit e shkollave: Memzotaj për shkollën vartëse “Kryezi”; “Sadi Tatani”, Rrakull; Memzotaj për shkollën vartëse Cikallesh; dhe “11 Shkurti” për shkollën vartëse Instituti i Riedukimit të të Miturve, rezulton se të gjitha kërkesat janë për kontratë pune me afat dhe të gjitha kontratat janë lidhur me mësues të renditur sipas portalit “Mësues për Shqipërinë”.

- Lidhur me pretendimin e ankueses se çdo vit shkollor i jam drejtuar zyrës arsimore për lëvizje paralele dhe nuk është gjetur vend si mësuese e profilit gjuhë-letërsi.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ankuesja me shkresën nr. 336, datë 27.05.2021, drejtur ZVAP Kavajë ka bërë kërkesë për lëvizje paralele për tu punësuar në qytet.

Me e-mail-in datë 01.09.2021, ZVAP Kavajë ka njoftuar ankuesen që të paraqitej në datë 02.09.2021 në ZVAP Kavajë për të pasur mundësinë e përzgjedhjes së vendit të punës në profilin Gjuhë Shqipe në shkollën 9-vjeçare Memzotaj (Cikallesh).

⁵ “Këtë vit bashkëshortja nuk ka aplikuar në portal, pasi ishte shtatzënë”.

Ankuesja me e-mail-in datë 01.09.2021, drejtuar ZVAP Kavajë, nuk ka pranuar propozimin duke shkruar se: *“Kërkesa që kam bërë për lëvizje paralele është për afrim në qytet”*.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e shkollës “Herbert”, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe kriteret, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për vlerësimin e dosjes së ankueses dhe H.RR ka pasur mundësinë për t’u ankuar për vlerësimin e dosjes nga ana e Komisionit të Vlerësimit të shkollës.
- Nga ana e ZVAP Kavajë, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe kriteret, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për vlerësimin e dosjes dhe renditjen e ankueses dhe H.RR ka pasur mundësinë për t’u ankuar për vlerësimin e dosjes dhe renditjen nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ZVAP Kavajë.
- Nuk rezultoi se në ZVAP Kavajë, të kishte pozicione të lira me kontratë pune me afat të pacaktuar, në profilin Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, në ndonjë shkollë tjetër dhe të mos i ishte ofruar ankueses.
- Ankuesja nuk është vendosur në asnjë moment në kushte të pafavorshme nga ana e drejtorisë së shkollës Herbert dhe nga ZVAP Kavajë.
- Ankuesja nuk ka qenë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë” për vitin shkollor 2023-2024, që të mund të përfitonte për vendet e punës me kontratë me afat, në profilin Gjuhë Shqipe dhe Letërsi dhe për mësues ndihmës.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimja e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ZVAP Kavajë dhe shkolla 9-vjeçare “Herbert”, nuk kanë ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e ZVAP Kavajë dhe shkollës “Herbert”, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se ZVAP Kavajë dhe shkolla “Herbert” kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses H.RR, në të drejtën për punësim, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë dhe shkollës 9-vjeçare “Herbert”, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA